



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. VI
Br. 2003 / 2026 - /N
No. 4
Data Datum 12.05.2026
No. Pg. Prishtinë / Pristina

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME
SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA – SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT

VERTETIMI MBI DOREZIMIN E DOKUMENTIT	POTVRDA O DOSTAVI DOKUMENTA	ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF A DOCUMENT
--	-----------------------------------	--

Numëri i lëndës: Br. predmeta : Case Number:	C-IV-24-0048	Data: Datum: Date:	04.05.2026
Titulli i dokumentit:	Naziv dokumenta:	Document name:	Datë/Datum/Dated:
AKTVENDIM			21.04.2026

Pala	Stranka	Party	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT- PRISHTINE
Pranuar nga	Primio:	Received by	
Titulli	Zvanje:	Title	
Data	Datum:	Date	
Nënshkrimi	Potpis:	Signature	



73



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2024:090727

Datë: 28.04.2026

Numri i dokumentit: 08818372

Dosja fizike: C-IV-24-0048

Parashtruesi i kërkesës

Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, Autoriteti i Likuidimit për N.SH "Extra" Vushtrri (në likuidim).

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Mr.sc. Bajram Miftari, me datën 21.04.2026, mori këtë:

AKTVENDIM

Aprovohet kërkesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në Prishtinë, Autoritetit të Likuidimit për NSH-në "Extra" ashtu që jepet pëlqimi për Agjencinë që të heq dorë nga Parcela Kadastrale nr. P-70202016-02045-3, ZK Vushtrri, parcela e regjistruar në emrin e MIT015 NSH "Extra" Vushtrri (në likuidim), P.SH. Ndërmarrja Prodhuese Kimike "Extra", me qëllim që aseti të regjistrohet si pronë publike.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me datën 04.03.2024, Agjencia Kosovare e Privatizimit- Autoriteti i Likuidimit për NSH "Extra" Vushtrri (në likuidim) ka ushtruar kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për të marrë leje nga gjykata për të hequr dorë nga Parcela Kadastrale nr. P-70202016-02045-3 ZK Vushtrri e regjistruar në emrin e MIT015 NSH "Extra" P.SH Ndërmarrja Prodhuese Kimike Extra. Në kërkesë ka theksuar se, Autoriteti i Likuidimit tash ka shqyrtuar kërkesat e ushtruara në procedurë të likuidimit, dhe kërkesa mbështetet në dispozitën e nenit 18 paragrafi 3.1 dhe 3.2 i Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në. MIT015 NSH "Extra" Vushtrri (në likuidim), është nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe po administrohet nga Autoriteti i Likuidimit, i emëruar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Duke pasur parasysh që aseti i përbërë nga parcela nr. P-70202016-02045-3 ZK Vushtrri me sipërfaqe totale prej 1734m² shfrytëzohet si rrugë publike, Autoriteti i Likuidimit erdhi në përfundimin që aseti nuk është në gjendje realizimi fitimprurës dhe tashmë ka marrë miratimin nga Bordi Drejtorëve të Agjencisë për të hequr dorë nga aseti. Përveç kësaj, në pajtim me nenin 11 të Ligjit



nr. 2003/11 për Rrugët *"Asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike"*.

Për më tepër, në kuptim të nenit 7 par. 1 Rregullores Nr. 04/2023 për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve i ka dërguar Kryetarit të Komunës së Komunës së Vushtrisë më datë 10 Janar 2024, kërkesë që të konfirmoj që parcela shfrytëzohet si rrugë dhe në bazë të dëshmisë KK Vushtrri e ka pranuar shkresën më datë 10 janar 2024. Autoriteti i Likuidimit ka pranuar përgjigje nga KK Vushtrri më datë 14.02.2024 ku Komuna ku konfirmon që parcela objekt i kësaj kërkesë është rrugë publike, e emërtuar si Rruga "Musli e Selim Drevinja". Pas aprovimit të kësaj kërkesë të Autoritetit të Likuidimit nga ana e DHPGJS, atëherë në përputhje me nenin 42 par.2 të Ligjit Nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, i cili specifikon që *"Në qoftë se hiqet dorë nga pronësia në një paluajtshmëri, atëherë pronësinë në atë paluajtshmëri e fiton subjekti publik kompetent në territorin e të cilës ndodhet paluajtshmëria"* pronësia mbi këtë aset do të kalojë mbi organin publik kompetent.


Kërkesës për heqje dorë nga aset i është bashkëngjitur: kopjen e vlerësimit/përcaktimit të miratuar të gjendjes (Raporti i Gjendjes në Terren), kopjen e Raportit të Gjendjes së Proceseve të Ndërmarrjes Shoqërore, kopjen e Njoftimit mbi Fillimin e procedurës së Likuidimit dhe Emërimit të Anëtarëve të parë të Komisionit të Likuidimit, kopjen e Njoftimeve për Fillimin e procedurës së Likuidimit në gazetën ditore, kopjen e Vendimit për Emërimin e Autoritetit të Likuidimit, kopjen e Certifikatës mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme 18-7231/19 e datës 23.10.2019, kopjen e shkresës për Kryetarin e KK Vushtrri e datës 10.01.2024 dhe përgjigjen e KK Vushtrri e datës 14.02.2024, kopjen e rekomandimit të Autoritetit të Likuidimit për Bordin e Drejtorëve për të hequr dorë nga aset datë 21.02.2024, kopjen e vendimit nga ana e Bordit të Drejtorëve datë 28.02.2024 për të hequr dorë nga aset.

Arsyetimi ligjor

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Agjencinë Kosovare e Privatizimit, Autoritetin e Likuidimit për NSH-në "Extra" Vushtrri (në likuidim) dhe jepet pëlqimi Agjencisë të heq dorë nga aset P-70202016-02045-3 ZK Vushtrri e regjistruar në emrin e MIT015 NSH "Extra" P.SH Ndërmarrja Prodhuese Kimike Extra.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, ka juridiksion për të vendosur në bazë të nenit 5 të Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për Ndërmarrjet apo Korporatat të cilat i nënshtrohen autoritetit administrativ të AKP-së.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, vlerëson se për rastin konkret Agjencia Kosovare e Privatizimit- Autoriteti i Likuidimit në kërkesën e saj për aprovimin e lejes për të hequr dorë nga parcela nr. P-70202016-02045-3 ZK Vushtrri e regjistruar në emrin e MIT015 NSH "Extra" P.SH Ndërmarrja Prodhuese Kimike Extra ka caktuar zyrtaret e saj për të vizituar gjendjen faktike në teren lidhur me aset, ka hartuar një raport me shkrim që është konstatuar se sipas certifikatës së pronës, parcela nr. P-70202016-02045-3 me sipërfaqe prej 1734 m² që sipas gjendjes faktike në terren shfrytëzohet si rrugë publike. Raportit ja ka bashkëngjitur edhe fotografi për të pasqyruar gjendjen faktike të ngastrës .



Duke pasur parasysh gjendjen faktike të ngastrës - asetit, gjykata pranon qëndrimin e Bordit të AKP-së, se aseti nuk mund të jetë fitimprurës për NSH -në, pasi në gjendje aktuale që është ngastra, AKP nuk do të mund të gjejë ndonjë blerës apo që i njëjti të përdoret për realizim të hyrave në dobi të NSH-së, kështu që në rastin konkret Dhoma Posaçme e Gjykatës Supreme jep pëlqimin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit për heqje dorë nga ky aset.

Me dispozitën e nenit 18, paragrafi 3, të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, është paraparë “Autoriteti i Likuidimit, me leje të Gjykatës, mund të heq dorë apo në mënyra tjera të zgjidh cilindo nga asetet e ndërmarrjes në vijim: 3.1 çdo aset problematik apo jo profitabil i cili, sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit të Likuidimit, nuk është në gjendje të ketë realizim fitimprurës, 3.2 çdo aset që sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit të Likuidimit nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e ndërmarrjes, Autoritetit të Likuidimit apo Gjykatës”.

Me rastin e dhënies së pëlqimit për heqje dorë nga aseti, gjykata vlerësoi se janë përmbushur kriteret që parashihet dispozita e nenit 18, paragrafi 3 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtari

Mr.sc. Bajram Miftari

